REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 6 para 1 pika 1.1, nenit 8 par 1 pika 1.1 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.04.2019 Nr.2019/10, Vendimet 15Nr-463-67001 të datës 01.11.2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës, dhe Vendimit 15.Nr.463-20393 të datës 29.03.2019, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

## NJOFTIM PUBLIK
## PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Vendimet e Kuvendit të Komunës 15Nr-463-67001 të datës 01.11.2018, 15.Nr.463-20393 të datës 29.03.2019 do të jep në shfrytëzim në afat prej 10 viteve 4 lokale me destinim për subjektet politike të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit si vijon:

| Nr | Njësia kadastrale | Adresa | Kati | Nr.i lokalit | Sipërfaqja m² | Gjithsej m² |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | O-71409044-01773-1-11-3-10<br>O-71409044-01773-1-11-3-11-0 | Rr. Sheshi "Adem Jashari" Lipjan | IV | / | 34.47m²<br>31.48m² | 65.95 m² |
| 2 | O-71409044-01773-1-11-3-12-0 | Rr. Sheshi "Adem Jashari" Lipjan | IV | / | 40.59 m² | / |
| 3 | O-71409044-01926-0-29-4-17-0 | Rr."Lidhja e Prizreni" Lipjan | BO | 6 | 81.35m² | / |

Njoftohen subjektet politike që kanë të themeluar degët e tyre në Komunën e Lipjanit, të cilët dëshirojnë të konkurrojnë me ofertat e tyre për marrje në shfrytëzim të lokaleve të cekura, se ankandi publik për vlerësimin e ofertave do të mbahet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë 29.05.2019, duke filluar nga ora 10:00.

Çmimi fillestar për periodën 10 vjeqare të shfrytëzimit të lokalave përcaktohet për sipërfaqen për çdo m² të lokalit në shumë prej 0.20€ (njëzet cent) për çdo m².

Pagesa e çmimit nga ofertuesi fitues në ankand do të bëhet në pajtim me Kontratën për dhënien në shfrytëzim për periodën 10 vjeqare të lokalit në dhjetë këste të barabarta me obligim të pagesës në momentin e nënshkrimit të kontratës për periodë 1 vjeqare (kësti i parë).

Lokalet do të ipen në shfrytëzim në gjendjen ashtu siq janë në ditën e shpalljes së këtij ankandi, kështu që pas lidhjes së kontratës, kërkesat për riparim të lokaleve dhe stabilimenteve nuk do jenë obligim dhe nuk do të miratohen nga Komuna për zbritjen e çmimit të kontraktuar.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 20 € (njëzet euro)

Një subjekt politik nuk mundë të përfitoj më shumë se një lokal të shpallur në këtë njoftim publik dhe poashtu subjektet politike që kan përfituar lokal nga shpalljet e kaluara nga Komuna nuk kan drejtë të aplikojnë prapë.

Në rast se dy e më shumë subjekte politike ofertojnë më të njëjtin çmim për të njëjtin lokal, përparësi ka subjekti politik që ka numër më të madh të votave në zgjedhjet e fundit.

Destinimi i lokalit nuk mundë të ndërrohet për nevoja tjera, por vetëm për nevoja të subjekteve politike.

Para nënshkrimit të kontratës vërtetohet gjendja aktuale e shërbimeve komunale të lokalit (rryma, uji, mbeturinat, etj) në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit me procesverbal. Subjektet politike përfituese marrin përgjegjësi nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pjesëmarrësve në ankand u garantohet e drejta që të:

-Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës
- Të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre ditë para mbajtjes së ankandit publik

Konkurimi për pjesëmarrje në Ankand bëhet duke dorëzuar aplikacionin me ofertë në kovertë të mbyllur.

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij njoftimi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi lokalin për të cilin konkurohet në ankand, çmimin ofertues të shënuar me numër dhe shkronja, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kovertë të mbyllur.
Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës së Lipjanit**

**Pjesëmarrje në Ankand Publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3.
Aplikacioni bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorëzohet brenda afatit prej 15 ditësh kalendarike nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi deri në ora 16:00 në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3.

Ofertat të paprecizuara, të panënshkrura dhe të ofertuara me çmim më të ultë se çmimi fillestar i publikuar me këtë Njoftim nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave në ankand publik marin pjesë nënshkruesit e ofertave.

Komisioni në ankand i bënë publike çmimet e ofertuara të secilës ofertë për lokalin përkatës.

Konform nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-092 së cekur më lartë, përmes ankandit publik Komisioni bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më lartë të ofruar në ankand publik.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do ti dërgohet fituesit, do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyra nr 106 Sektori për çështje pronësore-juridike ose në tel 038-200-41-507.

Nr. 1-463-31069
Me datë: 10.05.2019

Kryesues i Komisionit
Shkelzen Hajdini